



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më **21.12.2020**, me fillim në ora **10.00**.
Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Afrim Dina**.

Kryesuesi – Përshëndetje për të gjithë, i nderuar nënkryetar z. **Fatmir Iska**, te nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorët e drejtorive, përfaqësues të mediave dhe të gjithë të pranishmit e tjerë.

Të nderuar anëtarë të KPF-së, për këtë mbledhje propozoj këtë :

REND DITE

1. **Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
2. **Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për shpalljen “ Qytetar Nderi “ Gjeneralin Ton Van Loon,**
3. **Shqyrtimi i Propozim vendimit për miratimin e Planit të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2021,**
4. **Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës rreth shërbimeve të varrimit për vitin 2021,**
5. **Shqyrtimi i Propozim vendimit të komisionit për emërtimin e rrugëve, shesheve, lagjeve urbane rreth emërtimeve të reja,**
6. **Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike komunale me pronë private,**
7. **Shqyrtimi dhe marrja e vendimit për dalje në debat publik të Draft rregullores komunale për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës se Rahovecit,**
8. **Shqyrtimi i Planit vjetor i Prokurimit për vitin 2021,**
9. **Shqyrtimi i realizimit të Planit të punës për vitin 2020 të Auditorit të Brendshëm si dhe shqyrtimi i planit të punës për vitin 2021,**
10. **Shqyrtimi i Raportit të punës të Kuvendit Komunal për vitin 2020,**
11. **Të ndryshme**

Kryesuesi – Të nderuar kolegë kuvendarë, a jeni për këtë rend dite. Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës: Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar – A ka dikush diçka rreth procesverbalit. Atëherë me që nuk kemi, e qesim në votim. Konstatoj se unanimisht aprovohet procesverbali nga mbledhja e kaluar. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për shpalljen “Qytetar Nderi” Gjeneralin Ton van Loon.

Fatmir Iska – Përsëritje kryesues, të nderuar anëtarë të KPF-së dhe gjithë ju të pranishëm. Iniciativa ka qenë pikërisht prej ambasadorit në Mbretërinë e Holandës Lirim Graiqefci, pasi ky gjeneral ka shërbye pas luftës gjatë viteve 1999-2000. Unë besoj që ja vlen me përkrah këtë propozim për arsye se ka dhënë një kontribut në komunën tonë, sa ka qenë në shërbim të KFOR-it pikërisht në KFOR-in Holandez. Me diskutimet që kemi pasur edhe me Ismet Tarën njëri prej komandanteve që ka qenë pas çlirimit të komunës, e meriton një këtë vlerësim. Personalisht nuk e njoh mirëpo nga diskutimet që kemi pasur edhe që e kanë njohur gjatë luftës dhe pas çlirimit.

Kryesuesi - Faleminderit nënkryetar, mendoj se është nder edhe për neve që një gjeneral të shpallet nga komuna jonë qytetar nderi.

Fehmi Cena – Faleminderit kryesues, ju përsërites të gjithëve në këtë sallë. Unë veç desha me pyet për KFOR-in gjerman se a kanë marrë ndonjëherë ndonjë mirënjohje apo ndonjë nderim të ngjashëm sikur që tani po dëshiron me dhanë komuna, duke marrë parasysh se KFOR-i gjerman është i pari që ka hy në Rahovec dhe mendoj që janë me meritoret edhe për çlirimin e Rahovecit por edhe për ruajtjen e sigurisë e paqes në përgjithësi. Pra vetëm desha të informohem rreth kësaj.

Fatmir Iska – Deri me tani prej sa unë jam në dijeni rreth historisë së Komunës nga viti 2010 e deri më sot nuk e di që është shpallur ndonjë qytetar nderi apo eventualisht mirënjohje për përfaqësuesit e KFOR-it gjerman. Në mandatin e kaluar ka qenë shpallje e qytetar nderi ka qenë prej një shoqate e tash Hareja si trashëgimtare e saj, por përfaqësuesen e asaj shoqate e kam njohur nga afër, ka qenë grua gjermane dhe vërtet e ka merituar mirëpo unë personalisht kam qenë kundër për arsye se e kam krahasuar me gjeneralin Kudusi Lame, pasi nëse ajo shpërblehet me titullin qytetar nderi atëherë pse një gjeneral lufte jo, pra ky ishte krahasimi i asaj kohe, pra deri me tash nuk ka pasur. Kështu që tash nuk po flas si kryetar i Komunës, nëse e meriton dikush atëherë ka qenë përfaqësuesi i zyrës së OSBE-së në Rahovec, po ashtu gjeneral i pensionuar ishte Walter Flajsher, pasi kam punuar me këtë në OSBE që vërtet ishte person shumë i mirë dhe i ka vlerësuar çlirimtarët tanë të UÇK-së, pra ky do të ishte ai që e kishte merituar një çmim të tillë, prej stafit civil i cili ka dhënë një kontribut të madh në komunën tonë. Pastaj ata të KFOR-it gjerman ne mundemi me bisedua edhe me ushtarët dhe komandantët e luftës dhe mund marrim masa për të ardhmen mirëpo për momentin e kemi këtë propozim.

Dervish Çadraku – Faleminderit kryesues, përsëritje për të gjithë. Tash është fjala për një kandidat për me u shpall qytetar nderi që është propozuar nga dikush, prandaj nuk mund të themi për këtë propozim që të mos e shpallim deri sa të shpallen edhe të tjerët, pa dashtë me politizua mirëpo deri sa e kemi të propozuar tani për ta shpallë qytetar nderi kjo nuk do të thotë që të tjerët nuk e kanë këtë meritë dhe ne momentin kur të propozohen të tjerët atëherë ne përsëri do t'i shqyrtojmë kështu që ka mjaft njerëz meritorë që meritojnë të vlerësohen por tani pasi që kemi të propozuar këtë personalitet që ka kontribuar për komunën e Rahovecit atëherë është shumë me vend dhe e meritueshme pasi të gjithë e dimë për kontributin që ka dhanë në ruajtjen e paqes dhe sigurisë në vend, kështu që nuk kemi asnjë vërejtje sa i takon këtij propozimi .

Fehmi Cena – Për sqarim, nuk e kisha për ta kontestuar propozimin dhe kontributin e tij në shërbim të paqes në komunën e Rahovecit por vetëm desha me dit ndonjë informatë se a ka dikush nga ky rang që është shpallur qytetar nderi, pra vetëm këtë desha me ditë.

Kryesuesi – Faleminderit z. Cena, atëherë më qe nuk kemi tjerë të lajmëruar konstatojmë se kalon për kuvend pika e dytë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi i Propozim vendimit për miratimin e Planit të Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2021.

Skender Hamza – Pasi që jam edhe koordinator i Këshillit për Siguri në Bashkësi. Ky plan është i njëjtë sikur plani i vitit 2019, nuk ka ndonjë ndryshim por e vetmja pikë që është shtuar është pika sa i përket Covid-19. Në debat publik kemi kërkuar që me na dhanë ndonjë pikë shtesë nëse kanë të Këshillit për Siguri në Bashkësi por deri me tani nuk ka ardh asnjë pikë ne e-mail, kështu që ne duhet me votua këtë plan kështu siç është tani.

Kryesuesi – Faleminderit z. Hamza, më qe nuk kemi tjerë të lajmëruar, konstatojmë se kalon për Kuvend edhe pika e tretë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës rreth shërbimeve të varrimit për vitin 2021.

Samir Mustafa – Përshëndetje për të gjithë. Duke u bazuar në nenin 11/13 të ligjit për vetëqeverisje lokale të statutit të Komunës, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës projekt miratimin e vendimit me të cilin i lejohej Kryetarit të Komunës që me interes të qytetareve, mbulimin të shpenzimeve të varrimit me marrëveshje me publikun bashkësive fetare që veprojnë në territorin e komunës së Rahovecit . Pakoja e shërbimeve primare bëhet me një marrëveshje të re që nuk mund të kuotën me të lartë se 200 euro për një ceremoni të varrimit ndërsa për shërbime tjera të cilat nuk janë pjesë e kësaj marrëveshje qytetaret do t'i sigurojnë vet personalisht. Ju ftoj që ta miratoni propozimin e Kryetarit.

Kryesuesi – Faleminderit shume drejtor, po urdhëroni z. Cena!

Fehmi Cena – Sa kam mundur që ta vërejt, nuk ka ndonjë ndryshim në raport me vitin e kaluar, që po ashtu edhe te pakoja e shërbimeve është e njëjtë e po ashtu edhe te çmimi është njëjtë, pra nuk ka ndonjë ndryshim.

Samir Mustafa – Në konsultim me bashkësinë islame jemi marr vesh që të jetë ky por kemi pasur edhe kërkesa edhe vitin e kaluar nga asamblistët që të vendoset për therje të bagëtive mirëpo këto janë specifikat e bashkësisë islame dhe nuk mund të dalim jashtë shërbimeve që feja i lejon. Kemi raste që familjarët kërkojnë që varrin ta bëjnë me gurë apo me blloka të betoni mirëpo ato jashtë specifikave që nuk lejohen me marrëveshje.

Kryesuesi - Faleminderit shume drejtor, atëherë konstatojmë se edhe pika e katërt kalon për Kuvend. Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i Propozim vendimit të komisioni për emërtimin e rrugëve, shesheve, lagjeve urbane rreth emërtimeve të reja.

Dervish Çadraku – Faleminderit kryesues, unë e lexova materialin sa i përket kësaj pike, e kemi një praktikë jo shume të mirë sa i përket emërtimeve dhe figurave të ndryshme që i shpërputhim në qarkullim publik, ku kemi pasur raste në të kaluarën që me insistime disa punë janë krye. Por emërtimet që bëhen rrugëve me emra të njerëzve apo të veprimtareve të ndryshëm do të ishte mirë që të ju vendoset ka një biografi e shkurt që me pas mundësi me ditë rreth veprimtarisë së tij. Pasi kemi raste nëpër shumë lokalitete që vërtetë është shumë i panjohur si p.sh. në fshatin tim është emri mbiemri im në një lagje që është vendos emri i asaj rruge që realisht ai ka punuar për veti e jo për qytetarin. Prandaj këta njerëz që po i shoh me emra e me mbiemra do të ishte mirë që në Kuvend me na sjellë ka një biografi të shkurt se cila është veprimtaria e këtyre njerëzve që e meritojnë me ju vendos emri i rrugës me këtë emër.

Kryesuesi – Faleminderit z. Çadraku, sigurisht që është e vërtetë se komisioni gjatë punës që ka bërë që kam rastësisë me qenë i pranishëm e kom pa që i kanë trajtua edhe rreth çështjes së biografisë së atij emri, bile disa vendbanime që nuk kanë sjellë propozime nuk kanë sjellë biografi të atyre emrave, kështu që komisioni ka vendos që nuk mund të marrim vendim rreth atij propozimi pasi si komision nuk i njohim edhe nuk dimë rreth biografisë së atij emri. Gjithsesi në pjesën materialit e keni që në Kuvend të përgatitet edhe hartat që të jenë sa me të kompletuara.

Fehmi Cena – Është pak jo e qartë pasi nuk kemi askënd nga komisioni që ndoshta e kishim qartësua sot që në Kuvend mos me hap diskutime shumë. Unë pajtohem me Dervishin, se edhe unë mendoj se emërtimi i rrugëve është një çështje shumë serioze pasi që janë emra që duhet jenë me vlerë edhe që duhet të ju dihet biografia, emri që rrinë se paku 10 vjet sipas rregullës edhe gjithashtu këtu të dhëna po na mungojnë pak ndoshta biografia duket shumë për secilin që me ja bashkëngjit materialit, mirëpo kam vërejt se kur jemi tek emrat ku ceket emri ish-luftëtar por nuk ceket se a është dëshmor, a është i gjallë apo nuk është i gjallë, martir apo çfarë rasti është. Pastaj kam vërejt edhe disa mangësi tjera, qe realisht nuk dyshoj në seriozitetin e komisionit, për disa emërtime që nuk di sa janë në rregull p.sh. fshati Drenoc kishte shume propozime sa i përket emërimit të rrugëve pastaj fshati Dejnë, kështu që në fshatin Drenos lisi Pajates që qenka një lis, tash a do të ishte normale që edhe rrugës me ja dhanë emrin e lisit por se pari duhet të dihet se ky lis a është mbrojtur apo a është si trashëgimi kulturore apo paraprakisht a i kemi dhënë rëndësi atij lisi , pasi ai lis nëse vlen vetëm për atë lagje atëherë nuk ja vlen me pas edhe emrin e rrugës dhe nëse ai lis vërtet i ka mbi 300 vjet edhe dëshirojmë me ja dhanë një vlerë si Kuvend atëherë ka efekt. Kështu që po e quaj pak si anomali,

pastaj përsëri në Drenoc, propozimi parku të shitorja e Jupës të emërtohet kulla e Makshanëve. Kështu që tash vlen përsëri e njëjta gjë që kjo kulla e Makshanëve a është e vendosur në listën e trashëgimisë kulturore, a është afër atij sheshi apo brenda sheshi apo diku më larg p.sh. nëse kulla është në periferi të fshatit kurse sheshi në mes të fshatit prapë diçka nuk është në rregull në këto propozime për emërtime. Unë mendoj që emërtimet duhet ta kenë kuptimin e vet sikurse një roman e ka titullin e vet që e lexon titullin edhe pastaj e din pak e shumë përmbajtjen e atij romani edhe sheshi duhet ta ketë kuptimin e vet dhe jo vetëm sa për me i emërtua. Pastaj në faqen e fundit komisioni për emërtime të reja të rrugëve a vlen edhe kjo në këtë Kuvend apo kjo do të shqyrtohet me vonë p.sh. rruga transit mbi Rahovec të emërtohet toka e rrushit apo rruga Fortes-Hamoc të emërtohet Vreshtari, nuk e di a janë konsultua këta njerëz për këto emërtime dhe nuk e di a i përgjigjet kjo pasi krejt fusha e Rahovecit është vreshtari, nuk e di a është në rregull kjo apo ndoshta duhet të quhet rruga e Hamocit për arsye se kemi të bëjmë me Hamoc ose rruga e Dublanës që kemi të bëjmë me Dublanë. Kështu që a janë shqyrtuar këto emërtime si duhet pasi prapë po them se emri duhet ta ketë kuptimin e vet dhe duhet të jetë me plot kuptimin e fjalës.

Kryesuesi – Faleminderit z. Cena për të gjitha këto sqarime, sigurisht se kryesuesja e komisionit që është nga Kuvendi, znj. Besmire Bytyqi dhe anëtarët tjerë do të dalin në teren dhe do të raportojnë për të gjitha këto që ata që i kanë paraparë edhe i kanë dhanë këto mendime. Për të gjitha këto që i kanë adresuar për kuvend, deshta të ndalem tek propozimet e fshatit Drenoc dhe nuk do të thotë që në vendbanime tjera nuk ka emërtime por deri këtu kanë mbërri si komision me i trajtua duke i plotësuar ato vendbanime që i kanë sjellë propozimet për emërtime të bashkangjitura me biografi dhe të dhëna tjera sa i përket atij propozimi. Po ashtu edhe pjesa tjetër rreth sheshit të flamurit në fshatin Fortesë e që është e propozuar nga Kryetari dhe kryesia e fshatit sigurisht që për një propozim të tillë ata kanë marrë vendime bashkërisht por për me tepër na sqarojnë komisioni që e kemi në kuvend. Atëherë me që nuk kemi edhe tjetër të lajmëruar, kalon për kuvend edhe pika e pestë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike komunale me pronë private.

Afrim Oruçi – Faleminderit kryesues, të nderuar anëtarë të KPF-së, kolegë drejtorë dhe gjithë ju të pranishëm. Para juve keni propozimin e kryetarit të komunës për dhënien e pëlqimit të pronës publike komunale me pronë private. Bëhet fjalë për zonën kadastrale në Xerxë për hapje të rrugës publike. Për shkak të kushteve që jemi duke mbajtur këtë mbledhje, nuk kemi mundur me sigurua me ortofoto që me prezantua. Bëhet fjalë për parcelën 1015/10 që është pronë e shtetit dhe kësaj parcele i merret sipërfaqe prej 87m² dhe i jepet parcelës e cila është në posedim privat në emër të Faton Zenel Thaqit, që janë në kufij njëra me tjetrën ndërsa parcelës e cila figuron të pronari privat i merret e njëjta sipërfaqe prej 87m² dhe i bashkëngjitet rrugës parcelës me numër 1015/9. Pra bëhet fjalë për sipërfaqe të njëjte, ku para jush e keni edhe raportin e komisionit që është themeluar me vendim të kryetarit i cili komision ka dalë në vendin e ngjarjes dhe ka vlerësuar pronën që merret dhe që jepet, që është pronë e përafërt e njëjtë pasi është në kufij me parcelën private. Pra, parcela publike me parcelën private është e klasit të njëjtë dhe bëhet fjalë për sipërfaqe të njëjte. Kjo rrugë është e kalueshme dhe faktikisht është e shtruar me kubëza dhe kjo ka ndodhur në mandatin e kaluar pra në qeverisjen e kaluar të z. Vehapi dhe po duam me e rirregullua këtë problematikë që e njëjta mos me shkua në gjykatë. Ftoj anëtarët e KPF-së që të miratojnë propozimin e Kryetarit të Komunës për dhënien e pëlqimit për këmbim.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, atëherë me që nuk kemi tjerë të lajmëruar sa i përket kësaj pike, konstatojmë se kalon për Kuvend edhe pika e gjashtë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi dhe marrja e vendimit për dalje në debat publik të Draft rregullores komunale për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës së Rahovecit.

Kryesuesi – Kjo është një draft rregullore që së pari duhet të kryhen procedurat për dalje në debat publik e pastaj pasi të përfundon procedura e daljes në debat publik atëherë na vjen prapë në kuvend materiali. A ka dikush diçka rreth pikës së shtatë të rendit të ditës?

Fehmi Cena – Pra, është shumë mirë që po bëhet kjo rregullore për bashkëpunimin e komunës me këshillat e fshatrave dhe lagjeve urbane. Ne jemi ata që si delegat dhe anëtarë të KPF-së që kur kemi mbajtur dëgjime publike dhe po ashtu kemi kërkuar që është në rregull që kryetarët e fshatrave dhe lagjeve urbane të kompensohen pak për punën që të paktën për shpenzimet që krijohen dhe që i paguajnë vet që me u kompensua prej komunës dhe unë po e shoh se këtu janë të parashikuara në këtë rregullore ku thuhet më se shumti deri ne 6 takime por nuk është e cekur shuma dhe nuk e di a kemi të drejtë me diskutua ne për shumën apo ndoshta ekzekutivi i komunës e ka caktuar nuk e di rreth kësaj dhe sigurisht për të ardhmen duhet të ndahet një pjesë e buxhetit dhe te dihet se prej cilit pozicion do të ndahen. Po ashtu tek neni 14, kompensimi i kryetareve të këshillave lokale ku ceket ne pikën 3, kompensimi për pjesëmarrjen në takime bëhet vetëm për 6 muaj por është e paqartë pasi krijon hapësirë me u kuptua se edhe pjesëmarrësit tjerë të këshillit do të kompensohen apo vlen vetëm për kryetarët e këshillave?

Kryesuesi – Faleminderit z. Cena, rreth pyetjes që keni parashtruar se sa do jetë shuma rreth pagesës, ne edhe vitin e kaluar kemi pasur takime me kryesuesit e kuvendeve dhe me ministri ku është propozua që pagesa me u krye të paktën për 6 muaj nga komuna, që realisht do të jetë një pagë e barabartë me mëditjen e anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa, bile unë pata kërkuar që kjo mëditje të jetë më e madhe se sa e anëtarëve të Komitetit për Politike dhe Financa por sigurisht janë vendime që janë të planifikuara edhe me buxhetin. Unë mendoj se kryetarët e këshillave të fshatrave e meritojnë pak më shumë të kompensohen për angazhimet dhe punës që i kryejnë. Atëherë me që nuk kemi tjerë të lajmëruar, kalon për kuvend edhe pika e shtatë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i Planit vjetor të prokurimit për vitin 2021.

Astrit Mullaabazi – Raporti i planit të prokurimit është dorëzuar te kryetari i komunës para 1 dhjetorit, edhe planifikimi paraprak edhe planifikimi përfundimtar sipas ligjit të prokurimit bëhet 15 ditë pas miratimit të buxhetit në nivelin qendror dhe tash ne mundemi me diskutue vetëm sa i përket planifikimit paraprak të buxhetit që i është dorëzuar kryetarit të komunës para datës 1 dhjetor nga Zyra e Prokurimit.

Fehmi Cena – Deshta me pyet materialin që kemi ne a është paraprak apo final dhe për mbledhje a do ta kemi këtë material apo ndonjë material tjetër?

Astrit Mullaabazi – Pas miratimit të buxhetit nga ana e qeverisë nga Kuvendi i Kosovës atëherë 15 ditë pas miratimit atëherë duhet me bo planifikimin përfundimtar edhe me dërgua Agjencionit të Prokurimit.

Kryesuesi – Faleminderit z. Mullaabazi për sqarimin, atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar konstatojmë se edhe pika e tetë e rendit të ditës kalon për kuvend. Kalojmë në pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i realizimit të planit të punës për vitin 2020 të Auditorit të Brendshëm si dhe shqyrtimi i planit të punës për vitin 2021.

Ruzhdi Kabashi – Përshëndetje për të gjithë. Ne sipas planifikimit sipas planit vjetor për vitin 2021 kemi pasur të planifikuara 10 auditime dhe deri me tani janë të realizuara 8 dhe auditimi i nëntë është në përfundim, sot dorëzohet drafti dhe na ka ngelë vetëm drejtorja e Urbanizmit e cila ka qenë e paraparë të kryhet në muajin mars por për shkak të pandemisë e kemi shtyrë deri më sot dhe deri me datën 31 përfundohet dhe realizohet komplet plani i paraparë. Gjithashtu edhe planit për vitin 2021 kemi te paraparë 10 auditime, që si plan nuk është aprovuar nga kryetari dhe nga komiteti i auditimit, që sot pasdite kemi një takim me komitetin e auditimit dhe besoj që kryhet edhe kjo kështu që deri me datën 31 dhjetor duhet aprovohet dhe të dorëzohet njësisë qendrore të auditimit dhe Ministrisë së Financave.

Fehmi Cena – Te raporti i auditimit, e kisha pyet zyrtarin e auditimit tek rekomandimet që i ka cekur vetëm me numra por nuk e ka cekur përmbajtjen, pasi do të ishte mirë që edhe ne të kemi rekomandimet konkrete që i ka dhënë njësia e auditorit të brendshëm, pasi ne material nuk i kemi por vetëm në numra.

Ruzhdi Kabashi – Çdo raport kur të realizohet i dorëzohet kryetarit të komunës, që do të thotë se si njësi e auditimit i raportojmë direkt kryetarit të komunës. Kjo është vetëm si raport i punës tonë që kemi pasur si rekomandime kurse për pjesën detale të të gjeturave është ne kompetencën e kryetarit nëse e qetë ne komitet apo ne kuvend.

Kryesuesi – Faleminderit shume z. Kabashi, atëherë më qe nuk tjerë të lajmëruar, konstatojmë se edhe pika e nëntë e rendit të ditës kalon për kuvend. Kalojmë në pikën e dhjetë e rendit të ditës:

10. Shqyrtimi i Raportit të Punës të Kuvendit Komunal për vitin 2020.

Kryesuesi – Të nderuar kolegë, anëtarë të Komitetit për Politike dhe Financa, drejtorë dhe gjithë ju të pranishëm. Kuvendi gjatë këtij viti 2020 ka përmbushur të gjitha kriteret siç është e paraparë edhe në ligjin për vetëqeverisje lokale që Kuvendi të mbajë së paku 10 mbledhje, pra 5 mbledhje në 6-mujorin e parë dhe 5 mbledhje në 6-mujorin e dytë. Nëse Kuvendi i kemi mbajtur 11 dhe më mbledhjen e shtatë të KPF-së e kemi mbledhjen e 12-të dhe në mbledhjen e kuvendit të cilat do të jetë mbledhja e 12-të ku në raportin publik që bëhet publike në webfaqe të Komunës do të jetë i kompletuar me 12-të mbledhje. Të gjitha seancat që janë mbajtur janë trajtuar të gjitha pikat e rendit të ditës nga Komiteti për Politikë dhe Financa pastaj i janë rekomanduar Kuvendit dhe sidomos në mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa ka marrë pjesë çdo herë nënkryetari i Komunës. Mbledhjet që i kemi mbajtur kanë qenë të transmetuara dhe të hapura për publikun por edhe të monitoruara nga Ministria e Pushtetit Lokal. Deri më tani i kemi 94 pikat e rendit të ditës të cilat Komiteti për Politikë dhe Financa e pastaj Kuvendi i ka trajtuar kurse pikat tjera të shtatë dhe mbledhjes së ardhshme do të shtohen dhe do të kalojnë mbi 100-të pikat duke llogaritur edhe pikat shtesë. Komiteti për Politikë dhe Financa gjithashtu ka krijuar edhe obligimin tjetër të leximit buxhetor të cilat i ka organizuar dhe i ka mbajtur këtë vit që për shkak të pandemisë i kemi respektuar në përpikëri rekomandimet e IKSHP-së me maska dhe masa tjera mbrojtëse. Të gjitha prioritetet e marra nga vendbanimet i kemi marrë përmes kryetarëve të fshatrave dhe kryesive në vendbanime ku kemi qenë prezent, që po ashtu me neve ka qenë edhe drejtori i Financave dhe drejtorë tjerë të drejtorive komunale. Gjatë këtij viti i kemi mbajtur 11 mbledhje dhe po ashtu kemi pasur edhe dy mbledhje komemorativë me rastin e vdekjes së ish kryetarit të Komunës tonë z. Esat Haxhijaha dhe inspektorit tonë i cili ka ndërruar jetë z. Sabahudin Qeska. Gjithashtu është mbajtur edhe një mbledhje solemne ku kemi shpallur qytetar nderi me datën 14 qershor me rastin e ditës së çlirimit të Komunës tonë. Gjithashtu për më tepër jemi munduar me paraqitje dhe njëkohësisht po dua me falënderua edhe zyrën e Kuvendit z. Skender Hamza me bashkëpunëtorë rreth përgatitjes së raportit edhe pse kemi pasur disa probleme teknike me printerin por sigurisht që do të bëjmë përpjekje që për mbledhjet tjera të jenë të gjitha të dhënat sa më mirë. Kjo ishte sa i përket raportit të punës së kuvendit.

Fehmi Cena – Raporti është përmbajtësor mirëpo është për periudhën këtë periudhën kohore deri në nëntor dhe të them të drejtën tek rendi i ditës të pika e dhjetë Shqyrtimi i raportit të punës së Kuvendit Komunal, unë mendoj se me e logjikshme do të ishte plani i punës në atë punëtor që është krye që nuk kam qenë prezentë dhe nuk e a e kemi krye por edhe në planin e punës që e kemi bërë vitin e kaluar për vitin 2020 është paraparë në dhjetor me u krye diskutimi dhe aprovimi i planit sepse plani duhet të jetë para vitit kurse raporti duhet të jetë pasi të kryhet viti, pasi sa do të jeni i përgatitur tash në dhjetor prapë diçka mundet me mbete pasi nuk është krye periudha vjetore, kështu që këtë kam deshtë me propozua që ndoshta është me mirë që ne ta shqyrtojmë në mbledhjen e Kuvendit planin e vitit 2021 të Kuvendit Komunal kurse raportin me lanë për muajin janar. Tash nuk e dimë se si do të jetë e ngarkuar agjenda për muajin janar por sidoqoftë duhet ta diskutojmë pasi është edhe puna e jonë, kështu që ndoshta është vonë tash që po ndërhyje por ne po e shqyrtojmë këtë dhe me duket se është edhe me e logjikshme, edhe pse në planin e vitit 2020 ishte i paraparë edhe raporti edhe pasi që ta diskutojmë tash në dhjetor edhe pse do të ishte në rregull që plani të diskutohet në dhjetor kurse raporti pasi të kryhet viti kalendarik.

Kryesuesi – Është e vërtetë z. Cena, vitin e kaluar i kemi pasur të dyjat por edhe tash do t'i kemi të dyjat por në mbledhjen e kaluar për shkak të shëndetit që nuk ishte prezentë dhe na është kërkuar që plani i punës së kuvendit dhe plani i punës së kryetarit të komunës së pari të del në debat publik e pastaj të vjen në kuvend dhe në aktualisht e kemi në debat publik dhe për atë arsye kur të dalim në pikën në të ndryshme dua të ju informoj që në mbledhjen e kuvendit do të i kemi këto dy pikat sepse përfundon edhe afati ligjor i dalës në debat publik të planeve të punës dhe për atë arsye nuk kemi mundur që sot ta shqyrtojmë në KPF planin e punës së kuvendit dhe të kryetarit. Atëherë konstatoj se kalon për kuvend edhe pika e dhjetë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës:

11. Të ndryshme.

Siç e thash edhe më herët në kuvend do të kemi këto dy pikat të rendit të ditës që i kemi aprovuar në mbledhjen e kaluar që të jenë në debat publik pasi ato do të jenë në debat publik deri më datën 28 dhjetor të këtij viti. Sigurisht që dikush e ka dhënë kontributin e vet përmes e-maileve por në mbledhje do të kemi pikë

të rendit të ditës, planin e punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2021 dhe planin e punës së Kuvendit për vitin 2020, ku ne si Komitet për Politikë dhe Financa se bashku me drejtorët, e kemi mbajtur një takim që e kemi harmonizua rreth planit të punës për vitin 2021.

Fehmi Cena - E kam një propozim mbledhjen e kuvendit, ku kisha kërkuar që të përgatitet një informatë nga kryetari apo kush është kompetent për këtë në lidhje me sheshin e qytetit, pasi kemi shume pak informata sepse shume po flitet dhe gjithashtu e dimë se fundi ka qenë edhe konkursi për dizajnin e sheshit dhe meqenëse është një projekt i madh edhe ne si delegat dhe jo vetëm si qytetarë por edhe si delegatë duhet të dimë me shumë që me dit kur komunikojmë me qytetarin se si do të duket kjo. Pra, një informatë prej fillimit rreth një projekti ideor që unë për veti nuk e kam pa ndonjëherë dhe deri tash te kjo e fundit dizajnimi si do të duket dhe do të ishte mirë me pa edhe ne pamje në monitor që ta kemi të qartë sa me shumë, pasi është projekt madhor dhe milionësh dhe projekt i qytetit që mendohet me qenë me qindra vjet dhe mendoj se ne do të kishim interes me pas një informatë të hollësishme zyrtare nga komuna se si duket dhe deri ku ka ardhë çështja e këtij projekti. Pra, nëse pajtohen edhe delegatë tjerë që a ka nevojë me votua apo jo dhe unë mendoj se është e arsyeshme dhe e nevojshme.

Dervish Çadraku – Unë mendoj se kanë qenë edhe dy apo tre projekte tjera që kanë qenë në konkurrencë edhe qytetaret kanë folur edhe shkruajnë vazhdimisht në publik rreth planeve që kanë qenë në konkurs dhe do të ishte mirë që me i pa edhe ato projekte tjera që sa janë të arsyeshme ankesat e qytetareve.

Përparim Krasniqi – Përshëndetje për te gjithë. Kërkoj që në mbledhjen e radhës të futet ne rendin e ditës edhe një pikë shtesë për çështjen e deponisë ilegale për shkak se MAPL-ja na ka kthye ligjshmërinë pasi është në kundërshtim me ligjin për zero taksë për me hedhë në ankand publik deponinë ilegale dhe tash kërkohet çmimi fillestar së paku me caktua një çmim fillestar dhe unë e kisha marr një vendim në Kuvend nëse krijohet mundësia që me caktua një shifër sado e vogël për shkak se pa kosto dhe pa caktue një shifër financiare nuk mundet me u marr deponia ne menaxhime. Kështu që kish pas mundësi me qitë një pikë shtesë në rendin e ditës që në afatin e janarit me qitë ne ankand publik, për lokacionin që është caktuar në Rahovec dhe për deponitë tjera dhe të merret një shifër sado e vogël por të caktohet. Zyra Ligjore tash e përgatisin propozimin dhe arsyeshmërinë. Kështu që po kërkohet tani që te krijohet një propozim së paku 300 apo 400 euro për te gjitha deponitë ose e kufizojmë një pjesë prej 5 hektar pasi ne rregulloren e vjetër është e caktuar 2000 euro dhe operatorët ekonomik nuk po janë të gatshëm të marrin me pagua edhe me marr në menaxhim.

Kryesuesi – Atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, ju falënderoj te gjithëve për kontributin tuaj. Shihemi në mbledhjen e Kuvendit.

Procesmbajtësi,

Agim Hoti

